



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

Legjislacioni IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 26

Prishtinë, më 1 shkurt 2012, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Shaip Muja, Skender Hyseni, Sabri Hamiti, Donika Kadaj-Bujupi dhe Amir Ahmeti.

Munguan: Albin Kurti dhe Petar Miletqi.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Hydajet Hyseni – nënkryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 16 janar 2012;
3. Hartimi i Planit dhe i Programit të punës së Komisionit për vitin 2012;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Nënkryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 16 janar 2012

Nënkryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së datës 16 janar 2012 dhe u njoftua me shënimin zyrtar të takimit me delegacionin e Parlamentit të Hungarisë.

3. Hartimi i Planit dhe i Programit të punës së Komisionit për vitin 2012

Hydajet Hyseni - I njoftoi anëtarët e Komisionit se është shpërndarë një draft i Planit dhe i Programit të punës së Komisionit për vitin 2012, që është i nevojshëm të plotësohet dhe të miratohet brenda afatit të kërkuar.

Pas diskutimeve dhe propozimeve në Draftin e Planit dhe në Programin e punës së Komisionit për vitin 2012, nënkryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet Draftplani dhe Programi i punës së Komisionit për vitin 2012 me plotësimet si vijon:

1. Programi i punës së Komisionit të plotësohet me pikat:

- Ftesë për delegacionin e Komisionit të Jashtëm të Parlamentit të Hungarisë, në muajin maj;
- Iniciativa për takim me kryetarët e komisioneve të jashtme të vendeve të rajonit, në muajin shtator; si dhe
- Komisioni të ketë kontakte të vazhdueshme me PE-në, përkatësisht me Komisionin për Evropën Juglindore.

2. Plani i punës së Komisionit të plotësohet me pikat në vijim:

- Letër komisioneve homologe, vendeve që nuk e kanë njohur Kosovën e pavarur;
- Bashkëpunimi ndërparlamentar;
- Njohja prioriteti i Komisionit;
- Letër forumeve nderparlamentare, rajonale, etj.;
- Kërkesë për përfaqësim adekuat;
- Grupet e miqësisë dhe të bashkëpunimit me parlamentet e huaja dhe me forumet ndërparlamentare;
- Bashkëpunim me faktorët e tjerë në Kosovë, të angazhuar në fushën e punëve të jashtme;
- Bashkëpunim me përfaqësues të pranisë ndërkombëtare në Kosovë;
- Shqyrtimi i Raportit të Progresit, i raporteve, i rezolutave dhe i akteve të tjera ndërkombëtare për Kosovën;
- Shqyrtimi i marrëveshjeve ndërkombëtare në parim dhe veç e veç;
- Shqyrtim i ligjeve, si: për mërgatën, për fondet pensionale, për parqet, për Qeverinë, për buxhetin, për sigurimet, për financimin kundër terrorizmit, për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues, për sigurimin nuklear, për ujërat e Kosovës, për

telekomunikacionin, për zbarkimin e trupave jashtë vendit, për transportin e mallrave të rrezikshme, për treguesit gjeografikë, për investimet e huaja, për zonat ekonomike etj.;

- Përcjellja e procesit të negocimit dhe sigurimi i rolit të Komisionit;
- Pozita materiale egalitare e shërbimeve diplomatike;
- Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit të MPJ-së dhe të Ligjit të LMN-së, si komision funksional;
- Mbikëqyrja e ligjeve të tjera nga aspekti i marrëdhënieve ndërkombëtare;
- Ftesë komisioneve parlamentare homologe për vizitë në Kosovë;
- Tryezë me komisionet homologe lidhur me liberalizimin e vizave dhe lëvizjen e lirë;
- Aktivitete me rastin e përvjetorëve, si 100 vjetori i Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, ditët ndërkombëtare, si ajo e të drejtave të njeriut, e paqes, e mirënjohjes;
- Nisma për emërtimin e rrugëve dhe të shesheve me emra të personaliteteve të shquara miqësore ndërkombëtare;
- Komunikimi protokollar, telegrame urimi për festat kombëtare, eventualisht aktivitete të përbashkëta, fletëpalosje, faqja e internetit;
- Asistenca profesionale, ekspertiza NDI, PILPG (Public International Law Policy Group);

4. Të ndryshme.

1. Komisioni përkrahu Programin e vizitës së delegacionit të Parlamentit të Turqisë, për organizimin e një dreke më 6 shkurt 2012, nga buxheti i Komisionit për Punë të Jashtme.

2. Deputeti Shaip Muja tha se sjellja e kryetarit të Komisionit dhe qasja e tij ndaj Komisionit ka bërë që ky Komision të reflektojë i izoluar dhe i papërkrahur. Lidhur me këtë çështje tha se, ka paraqitur një letër me të cilën kërkon të vlerësohet pozicioni i kryetarit për arsyeshmërinë e politikës izoluese që e ka shkaktuar, për shkeljen e ligjit dhe për dëmtimin e kredibilitetit të Kosovës në rrafshin ndërkombëtar.

Anëtarët e Komisionit vlerësuan se shkresa e deputetit Shaip Muja nuk mund të shqyrtohet pa praninë e kryetarit të Komisionit.

Deputeti Shaip Muja kërkoi që shkresa e tij të jetë pikë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës së Komisionit.

Takimi përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetari i Komisionit

Hydajet Hyseni

